



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-013

Prishtinë, më 21 dhjetor 2017, në orën 17:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 21 DHJETOR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala, Xhavit Haliti dhe Slavko Simiq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Armend Zemaj, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se mbledhja e sotme është thirrur me kërkesë të kryeministrit të Kosovës për seancë të jashtëzakonshme më 22 dhjetor, në orën 14:00, me këtë rend dite: *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018*.

Ndërkohë, pas shpërndarjes së ftesës, nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, i mbështetur nga gjashtë deputetë, kërkoi që të radhiten edhe dy pika shtesë.

1. *Debat parlamentar për raportin 100-ditësh të punës së Qeverisë dhe*
2. *Interpelanca e kryeministrit, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së datës 7 dhjetor 2017*

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me propozimet e lartshënuara.

Nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, kërkoi që dy kërkesat e GP të LDK-së të radhiten në rend dite të seancës plenare.

Me kërkesë të kryetarit të Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, sqaroi se mbledhja e sotme është thirrur për një pikë të rendit të ditës, kërkesa e kryeministrit për seancë të jashtëzakonshme për datën 22 dhjetor, në orën 14:00, ndërsa çështjet e shtruara nga nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, dhe gjashtë deputetë të tjerë, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, Kryesia e Kuvendit siguron që çfarëdo mocioni përmbajtësor në afat prej tri javësh mund të radhitet në rend dite të seancës plenare.

Gjithashtu, nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, kërkoi nga Kryesia e Kuvendit që të distancohen nga deklarimi i nënkryetarit të Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Nasim Haradinaj, lidhur me vrasjet e veprimtarëve të LDK-së.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me çështjen e shtruar.

Lidhur me çështjen e shtruar nga nënkryetari Kujtim Shala diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Ahmet Isufi, Armend Zemaj, Bilall Sherifi, Memli Krasniqi dhe nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund të këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se gjuha e përdorur nga nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Nasim Haradinaj, është e papranueshme, është në dëm të stabilitetit, dhe e cila i ka lënduar njerëzit.

* * *

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, vendosi që seanca e jashtëzakonshme të mbahet më 22 dhjetor, në orën 14:00, me rendin e ditës:

1. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018*

Pastaj, kryetari i pyeti nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare nëse dëshirojnë që kjo të jetë seanca e fundit e Sesionit vjeshtor, apo dëshirojnë të mbahet edhe një seancë tjetër.

Lidhur me propozimin e kryetarit të Kuvendit diskutuan: Glauk Konjufca, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi, Kujtim Shala, Xhavit Haliti dhe Memli Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pasi nuk pati konsensus, kryetari e hodhi në votim propozimin për përfundimin e Sesionit vjeshtor.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 3,
Kundër ----- 1,
Abstenim ----- 0.

Kryetari konstatoi se pas përfundimit të seancës së nesërme të jashtëzakonshme, pasi të kryhet nesër, që nga dita e hënë të mbyllet Sioni vjeshtor deri në javën e tretë të janarit 2018.

Në fund, kryetari ua uroi të pranishmëve festat e fund vitit.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 18:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale